



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 18.05.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në
orën 10:30 dhe mbaroi në orën 11:10.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, do të vijojë shorti për Gjykatën Administrative të Apelit, më pas shorti do të vijojë për gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm si: për Gjykatën e Apelit Durrës, për Gjykatën e Apelit Vlorë, për Gjykatën e Apelit Korçë, për Gjykatën e Apelit Shkodër, për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, dhe në fund do të vijojë shorti për gjykatat e shkallës së parë si: për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe në fund për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Gjyqtari duhet të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtarja që është caktuar në shortin e mëparshëm, për të gjykuar një çështje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Alma Kolgjoka.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, i cili mundësohet nga specialistë të Misionit EURALIUS dhe nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Ornela Naqellari, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z. Ridvan Hado. Gjithashtu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-KLD-ja dhe nuk janë rikthyer ende në detyrë, konkretisht: z. Gjin Gjoni

dhe znj. Evjeni Sinoimeri.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen gjyqtarët Zegjine Sollaku dhe Artur Gaxha, të cilët caktohen për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, 3 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: z. Astrit Kalaja.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Aleks Nikolli.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtaret Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Aleks Nikolli.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Lindita Hoxha (relatore), Vojsava Osmanaj dhe Aleks Nikolli (anëtarë)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Gjyqtari i caktuar si relator për çështjen nr.2 ku kërkohen 3 gjyqtarë, nuk përfshihet në short në çështjen nr.1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: z. Dritan Banushi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: znj. Miranda Andoni.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Irena Brahimi (relatore), Enton Dhimitri dhe Izet Salaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Irena Brahimi.

Ripërsëritet shorti, pasi sipas propozimit të Komisionit shorti nuk duhet t'i binte gjyqtarës e cila është relatore për çështjen nr. 2.

Nga rishortimi elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Irena Brahim.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Enton Dhimitri (relator), Izet Salaj dhe Irena Brahim (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 10 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 9 në lëndë penale.

Kërkesat me numër rendor 1 dhe 2 të Gjykatës së Apelit Korçë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr.74, datë 20.02.2020, “Për Komandimin e gjyqtarës znj.Mimoza Margjeka në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar”, si dhe Vendimin nr.75,

datë 20.02.2020, me të cilin “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.Mimoza Margjeka caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020”.

Për rrjedhojë, nevojat për 2 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht ato me numër rendor 1 dhe 2, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një gjyqtar më pak.

Në këto kushte, për kërkesat nr.1 dhe nr.2 si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë tashmë kanë mbetur pa objekt sa i përket kërkimit të caktimit të 1 gjyqtari dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të procedojë vetëm sa i përket nevojës së caktimit të dy gjyqtarëve në secilën nga këto çështje.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 8 gjyqtarë, 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 6 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Për 4 çështje penale, ato nr.1, nr.3, nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për 3 çështje të tjera penale, ato nr.2, nr.6 dhe nr.9, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për 2 çështjet penale, ato nr.7 dhe nr.8, për të cilat kërkohen 1 gjyqtar, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë përzgjedhur më parë me short për gjykimin e këtyre çështjeve, konkretisht gjyqtarja Valdete Hoxha për çështjen nr.7 dhe gjyqtari Alaudin Malaj për çështjen nr.8.

Për 1 çështje civile, atë nr.10, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë përzgjedhur më parë me short, gjatë muajit prill 2020, për gjykimin e nga një çështje në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht gjyqtaret Zegjine Sollaku dhe Elona Toro.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Durrës, konkretisht: z. Ridvan Hado

dhe z. Desart Avdulaj si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-KLD-ja dhe nuk janë rikthyer ende në detyrë, konkretisht: z. Gjin Gjoni dhe znj. Evjeni Sinoimeri. Gjithashtu të përjashtohen nga shorti në çështjet nr. 2, nr. 6 dhe nr. 9 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Korçë gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, konkretisht: z. Alaudin Malaj, znj. Valdete Hoxha, znj. Zegjine Sollaku dhe znj. Elona Toro.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shpresa Beçaj.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shpresa Beçaj.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shpresa Beçaj.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Alaudin Malaj.

Për çështjen nr. 10, civile, gjyqtaret Zegjine Sollaku dhe Elona Toro.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale, ku ka kërkuar 2 gjyqtarë.

Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër bën me dije se për gjykimin e çështjes si më sipër kanë pengesë ligjore gjyqtarët Astrit Kalaja, Lindita Hoxha, Valbona Vata dhe Vojsava Osmanaj, ndërsa gjyqtari Selim Kryeziu është relator në këtë çështje. Sa i përket gjyqtarit Aleks Nikolli nuk rezulton që ai të ketë ndonjë pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështje, por parashtrohet se ai është me raport mjekësor. Për këtë arsye,

Gjykata e Apelit Shkodër ka kërkuar caktimin e jo të një, por të dy gjyqtarëve, për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes së mësipërme.

Në kushtet kur për çështjen e mësipërme konstatohet se gjyqtari Aleks Nikolli nuk ka asnjë pengesë ligjore për gjykimin e saj, por ka qenë me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme për punë, nevoja e gjykatës nuk është për dy gjyqtarë, por vetëm për një. Qenia e një gjyqtari me raport mjekësor nuk përbën shkak për përjashtimin nga gjykimi i një çështje gjyqësore konkrete. Për rrjedhojë, në këtë rast, nuk jemi para rastit të mungesës apo padisponueshmërisë së gjyqtarit për të gjykuar çështjen, në kuptim të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të procedojë për trajtimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit Shkodër vetëm sa i përket nevojës së identifikuar për caktimin e 1 gjyqtari në çështjen gjyqësore si më lart.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-KLD-ja dhe nuk janë rikthyer ende në detyrë, konkretisht: z. Gjin Gjoni dhe znj. Evjeni Sinoimeri si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Korçë gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, konkretisht: z. Alaudin Malaj, znj. Valdete Hoxha, znj. Zegjine Sollaku dhe znj. Elona Toro. Gjithashtu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që mund të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, që rezultuan znj. Shpresa Beçaj dhe Genti Shala.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Shkëlqim Mustafa, i cili caktohet për të

gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, 3 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe numri i gjyqtarëve të jetë të jetë 5, 2 nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 3 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për 4 çështje, ato nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.6, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Për 2 çështje, ato nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohen nga 3 gjyqtarë, të caktohen 3 nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë rast një gjyqtar nuk duhet të përzgjidhet relator në të dy çështjet.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Iliba Bezati dhe znj. Nertina Kosova.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Klodiana Gjyzari.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtari Klodiana Gjyzari.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarët Skënder Damini dhe Klodiana Gjyzari.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Skënder Damini.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Sokol Binaj (relator), Albana Boksi dhe Nure Dreni (anëtarë).

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Albana Boksi (relatore), Sokol Binaj dhe Nure Dreni (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, konkretisht: z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Rexhep Karaj, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, konkretisht: z. Edvan Veçani si të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që sipas informacioneve të mbërritura më parë nuk është paraqitur në detyrë për një periudhë të

gjatë kohore për arsye shëndetësore, konkretisht: znj. Nertila Kape.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Ardit Kuka, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: z. Arbër Çela si të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka pengesë ligjore për gjykimin e tyre, konkretisht: z. Sokol Shehu.

Komisioni ka edhe një propozim sa i përket mospërjashtimit nga shorti, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, si dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: znj. Flutura Hoxha.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Amarilda Sulaj (relatore), Tonin Stërkaj dhe Flutura Hoxha (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Tonin Stërkaj (relator) dhe Amarilda Sulaj dhe Flutura Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zv/kryetare) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: znj. Luljeta Kole.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Maksim Qirjazi, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Mirela Kore (Iliopulli), e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

* * *

(Mbledhja konsiderohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor